Vendim nr. 84, datë 24.09.2026

(V- 84/26)

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Fiona Papajorgji, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Sandër Beci, Genti Ibrahimi, Marjana Semini, Ilir Toska, anëtarë, me sekretare Farisja Idrizaj, në datën 24.09.2026, mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 53 (A) 2025 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: **ARBEN KOVAÇI** përfaqësuar nga avokati Rudin Deda, me prokurë.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

KËSHILLI I MINISTRAVE, përfaqësuar nga Herald Jonuzaj, me autorizim.

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË, në mungesë.

AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR, përfaqësuar nga drejtori i përgjithshëm, Ami Kozeli.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimeve nr. 566 (80-2016-584), datë 15.02.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë; nr. 2240, datë 31.05.2018 të Gjykatës Administrative të Apelit; nr. 00-2025-2119, datë 03.06.2025 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

BAZA LIGJORE: **Nenet 41, 42, 131, pika 1, shkronja "f", dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 6 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut *(KEDNJ)*; nenet 71 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të**

Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Ilir Toska, mori në shqyrtim parashtrimet me shkrim të kërkuesit Arben Kovaçi *(kërkuesi),* i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjekteve të interesuara, Këshillit të Ministrave dhe Autoritetit Rrugor Shqiptar *(ARRSH),* që kanë kërkuar rrëzimin e kërkesës, konstatoi mungesën e prapësimeve me shkrim të subjektit tjetër të interesuar, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë *(MIE),* si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi ka qenë pronar i pasurisë së llojit "tokë arë", me sipërfaqe 7930 m^2, me nr. 29/28, e ndodhur në Fushë-Milot, zona kadastrale nr.1677, dhe e regjistruar në regjistrat e pasurive të paluajtshme. Me vendimin nr. 802, datë 13.12.2006 "Për shpronësimin për interes publik të pasurive të paluajtshme që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Milot-Rrëshen" të Këshillit të Ministrave *(VKM-ja nr. 802/2006),* kërkuesi është shpronësuar për sipërfaqen 1196 m^2 të kësaj pasurie, me çmimin 900 lekë/m^2. Pas shpronësimit, sipërfaqja e mbetur prej 6734 m^2 është ndarë në tri pasuri të veçanta, të regjistruara me këta numra dhe sipërfaqe: nr. 29/39, me sipërfaqe 1846 m^2; nr. 29/41, me sipërfaqe 2444 m^2 dhe nr. 29/42, me sipërfaqe 2444 m^2.

2. Pas ndërtimit të këtij segmenti rrugor, ARRSH-ja, në funksion të realizimit të projektit "Nyja lidhëse Milot-Lezhë, Milot-Rrëshen dhe Milot-Thumanë", në zbatim të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik" *(Ligji i Shpronësimit)* dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij, në prill 2014 ka filluar procedurat paraprake, duke kryer vlerësimin e pasurive, identifikimin e pronarëve dhe matjet sipas projektit, me qëllim përcaktimin e sipërfaqeve që prekeshin prej tij. Në vijim, ajo i ka kërkuar Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës (sot Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë) miratimin e shpronësimit për interes publik.

3. Në kuadër të kësaj procedure, Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës *(MTI),* bazuar në pikën 7 të vendimit nr. 138, datë 23.03.2000 "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive pronë private që shpronësohen, të pasurive që

zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik", të ndryshuar, të Këshillit të Ministrave *(VKM-ja e Kritereve Teknike të Vlerësimit)*, të miratuar në zbatim të neneve 17 dhe 18 të Ligjit të Shpronësimit, me shkresën nr. 2451/6 prot., datë 23.10.2014, i ka kërkuar Ministrisë së Financave miratimin e procedurës përjashtimore të vlerësimit të pasurive në zonën kadastrale ku ndodheshin edhe pasuritë e kërkuesit. Pika 7 e VKM-së së Kritereve Teknike të Vlerësimit parashikonte mundësinë e zbatimit të një procedure përjashtimore për vlerësimin e pasurive që shpronësoheshin për akset rrugore kombëtare, me miratimin paraprak me shkrim të ministrit të Financave. Në rast refuzimi të miratimit, procedura e vlerësimit vijonte në bazë të hartës së vlerës.

4. Në rastin konkret, kërkesa e MTI-së është mbështetur në të dhënat e konfirmuara nga Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Kurbin, në korrik 2014, sipas të cilave çmimi mesatar i shitblerjeve të realizuara gjatë tre muajve të fundit për pasuritë e llojit "tokë arë" në atë zonë kadastrale ishte 751,54 lekë/m^2, ndërkohë që, sipas konfirmimit të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, vlera e këtyre pronave, bazuar në vendimin nr. 187, datë 06.03.2013 "Për miratimin e vlerës së pronës për secilin qark të Republikës së Shqipërisë" të Këshillit të Ministrave (*VKM-ja e Vlerës së Pronës 2013*) ishte 347 lekë/m^2.

5. Kërkesa e MTI-së për zbatimin e procedurës përjashtimore të vlerësimit të pasurive në zonën kadastrale ku ndodheshin edhe pasuritë e kërkuesit nuk është miratuar nga Ministria e Financave. Në vijim, me propozim të MTI-së, Këshilli i Ministrave, me vendimin nr. 511, datë 10.06.2015 *(VKM-ja nr. 511/2015)*, ka vendosur shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që prekeshin nga projekti rrugor në fjalë. Në këtë vendim janë përfshirë edhe pasuritë e kërkuesit nr. 29/39, nr. 29/41 dhe nr. 29/42, me sipërfaqet e shpronësuara, përkatësisht 1846 m^2, 2444 m^2 dhe 1674 m^2, në total 5964 m^2. Çmimi i shpronësimit është përcaktuar 347 lekë/m^2, ndërsa shpërblimi i përgjithshëm për këto pasuri në shumën 2.069.508 lekë. Kjo shumë është përllogaritur në bazë të VKM-së së Kritereve Teknike të Vlerësimit dhe VKM-së së Vlerës së Pronës 2013.

6. Me pretendimin se masa e shpërblimit për pasuritë e shpronësuara nuk i përgjigjej vlerës reale të tregut, kërkuesi, në datën 21.07.2015, ka paraqitur padi kundër Këshillit të Ministrave, MTI-së dhe ARRSH-së, duke kërkuar ndryshimin e pjesshëm të VKM-së nr. 511/2015 dhe përcaktimin e shpërblimit për pasuritë e shpronësuara sipas vlerës së tyre reale. Po kështu, ai ka kërkuar kompensim sipas vlerës së tregut për zhvlerësimin e sipërfaqes 770 m^2, pjesë e pasurisë nr. 29/42, e cila kishte mbetur jashtë shpronësimit, por, sipas tij, ishte denatyruar dhe bërë e pashfrytëzueshme për shkak të realizimit të projektit rrugor. Në mbështetje të pretendimeve të tij,

kërkuesi ka paraqitur një raport vlerësimi të hartuar me kërkesën e tij nga një vlerësues i pasurive të paluajtshme, sipas të cilit, bazuar në analizën e çmimeve sipas metodës së krahasimit të drejtpërdrejtë, metodës së tregut dhe metodës së zhvillimit të pronës, vlera në tregun e lirë e pasurive të kërkuesit, të llojit "tokë arë", ishte në masën 3800 lekë/m^2.

7. Gjatë gjykimit, me kërkesë të kërkuesit, gjykata ka vendosur kryerjen e një ekspertimi teknik vlerësues. Në aktin e ekspertimit të administruar si provë në gjykim, eksperti, ndër të tjera, ka përllogaritur vlerën e pasurive të shpronësuara të kërkuesit, duke përdorur si baza krahasimi: i) VKM-në e Vlerës së Pronës 2013, me çmimin që, sipas tij, ishte 381 lekë/m^2; ii) vendimin nr. 514, datë 30.07.2014 "Për miratimin e vlerës së pronës për secilin qark të Republikës së Shqipërisë" të Këshillit të Ministrave, me çmimin 350 lekë/m^2; iii) VKM-në nr. 802/2006, me çmimin 900 lekë/m^2; iv) çmimin mesatar të tregut të lirë prej 2955 lekë/m^2.

8. Në përfundim të gjykimit, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Tiranë, me vendimin nr. 566 (80-2016-584), datë 15.02.2016, ka pranuar pjesërisht padinë e kërkuesit, duke ndryshuar VKM-në nr. 511/2015 për pjesën që lidhej me masën e shpërblimit për pasuritë nr. 29/39, nr. 29/41 dhe nr. 29/42, duke detyruar MTI-në dhe ARRSH-në t'i paguanin kërkuesit: (i) shumën 202.776 lekë, si diferencë shpërblimi për pasuritë e shpronësuara; (ii) shumën 293.370 lekë, si kompensim për zhvlerësimin e sipërfaqes 770 m^2 që kishte mbetur jashtë shpronësimit. Kundër këtij vendimi kanë paraqitur ankim kërkuesi, MTI-ja dhe ARRSH-ja.

9. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 2240, datë 31.05.2018, ka ndryshuar vendimin e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, duke pranuar pjesërisht padinë e kërkuesit dhe duke detyruar MIE-në dhe ARRSH-në t'i paguanin atij shumën 267.190 lekësh si kompensim për zhvlerësimin e sipërfaqes 770 m^2, ndërsa ka rrëzuar kërkimet e tjera të padisë. Kundër këtij vendimi kanë ushtruar rekurs kërkuesi, MIE-ja dhe ARRSH-ja. MIE-ja dhe ARRSH-ja, më pas, kanë hequr dorë nga rekurset e tyre.

10. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2025-2119, datë 03.06.2025, pas shqyrtimit të rekurseve në dhomën e këshillimit, ka vendosur mospranimin e tyre. Për rekurset e MIE-së dhe ARRSH-së Kolegji Administrativ ka marrë parasysh heqjen dorë prej tyre, ndërsa për rekursin e kërkuesit ka vlerësuar se ai nuk përmbante shkaqe ligjore nga ato të parashikuara nga neni 58 i ligjit nr. 49, datë 03.05.2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", të ndryshuar (*ligji nr. 49/2012*).

11. Në datën 10.11.2025 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të nenit 27

të Ligjit Organik të Gjykatës, është regjistruar në datën 18.11.2025. Kolegji i Gjykatës, në datën 13.01.2026, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve. Në vijim, Mbledhja e Gjyqtarëve ka pranuar kërkesën e një anëtari të Gjykatës për heqjen dorë nga shqyrtimi i çështjes, ndërsa një anëtar tjetër nuk mori pjesë në seancë plenare, pasi mungoi për arsye objektive. Për këtë të fundit, Gjykata vlerësoi të vijonte me shqyrtimin e çështjes, pasi plotësohej kuorumi i nevojshëm për shqyrtimin në seancë plenare, sipas nenit 32, pika 1, të Ligjit Organik të Gjykatës.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

12. ***Kërkuesi,*** në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i janë cenuar:

12.1. *E drejta për proces të rregullt ligjor,* e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në aspektet e mëposhtme:

12.1.1. *E drejta e aksesit substancial në gjykatë,* pasi gjykatat e juridiksionit të zakonshëm nuk i kanë siguruar mbrojtje gjyqësore efektive ndaj vendimmarrjes së organeve administrative dhe nuk i kanë dhënë përgjigje pretendimit të tij thelbësor për masën e shpërblimit të drejtë për pasuritë e shpronësuara. Gjykatat administrative, megjithëse kishin detyrimin të kontrollonin ligjshmërinë e vlerësimit dhe të korrigjonin gabimet e organeve administrative, kanë lënë në fuqi vlerësimin e këtyre të fundit pa shqyrtuar në mënyrë efektive faktet dhe provat e paraqitura nga ai, duke ligjëruar "grabitjen" e pronës dhe duke e lënë atë praktikisht pa mbrojtje gjyqësore efektive.

12.1.2. *E drejta për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme dhe parimi i barazisë së armëve,* pasi gjykatat kanë mbajtur qëndrim të njëanshëm në favor të organeve të administratës. Në veçanti, Gjykata Administrative e Apelit është përqendruar gjerësisht në shqyrtimin e ankimeve dhe të pretendimeve të organeve publike, sikur të kishte në shqyrtim padinë e tyre, ndërsa nuk u ka dhënë të njëjtën vëmendje pretendimeve dhe argumenteve të tij. Po kështu, gjykatat kanë pranuar *a priori* aktet e vlerësimit të palëve të paditura, pa u dhënë të njëjtën peshë provave shkresore, aktit të ekspertimit dhe

argumenteve të tij, duke e vendosur atë si "palën më të dobët", në pozitë të pabarabartë me administratën.

12.1.3. *Standardi i arsyetimit të vendimit gjyqësor,* pasi gjykatat e juridiksionit të zakonshëm nuk u kanë dhënë përgjigje të arsyetuara pretendimeve të tij thelbësore. Në veçanti, Gjykata e Lartë është mjaftuar me arsyetimin se rekursi i tij nuk përmbante shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 58 i ligjit nr. 49/2012, pa iu përgjigjur pretendimeve për zbatimin e gabuar të ligjit material dhe procedural, shmangien nga praktika e konsoliduar e saj dhe shkeljet procedurale të ngritura në rekurs. Gjykatat e faktit nuk kanë shpjeguar se përse një pjesë e së njëjtës pasuri ishte shpronësuar në vitin 2006 me çmimin 900 lekë/m^2, ndërsa pjesa tjetër, pas 9 vjetësh, me 347 lekë/m^2. Ato nuk kanë marrë në konsideratë raportin e vlerësimit të paraqitur prej tij, sipas të cilit vlera e tregut të lirë e pasurive është 3800 lekë/m^2, si dhe aktin e ekspertimit të administruar në gjykim, në të cilin çmimi mesatar i tregut është përllogaritur në vlerën 2955 lekë/m^2. Po kështu, Gjykata Administrative e Apelit nuk i ka dhënë përgjigje pretendimit se, për shkak të projektit dhe lejes së ndërtimit të rrugës, pasuria e tij duhej të konsiderohej "truall" dhe jo tokë bujqësore. Ajo ka rrëzuar edhe kërkesën e tij për heqjen dorë nga gjykimi i kërkimit të padisë që lidhej me sipërfaqen 770 m^2, duke interpretuar dhe zbatuar gabim nenin 201 të Kodit të Procedurës Civile (*KPC*), sipas përmbajtjes së tij në kohën e fillimit të gjykimit, pra përpara ndryshimeve të bëra me ligjin nr. 38/2017. Për më tepër, duke disponuar për këtë kërkim pavarësisht kërkesës për heqjen dorë, gjykata ka cenuar parimin e disponibilitetit të padisë sipas nenit 6 të KPC-së.

12.1.4. *E drejta për gjykim brenda një afati të arsyeshëm,* pasi Gjykata Administrative e Apelit e ka shqyrtuar çështjen rreth 2 vjet e 3 muaj pas dhënies së vendimit nga gjykata e shkallës së parë, në kundërshtim me kërkesën për zhvillimin e gjykimit administrativ brenda afateve të shpejta të parashikuara nga ligji.

12.2. *Parimet e barazisë përpara ligjit dhe të sigurisë juridike në aspektin e pritshmërive të ligjshme dhe të zbatimit të njëtrajtshëm të ligjit,* të garantuara nga nenet 4 dhe 18 të Kushtetutës, pasi Gjykata Administrative e Apelit në çështje të tjera për të njëjtat

shkaqe dhe objekt, ka pranuar se shpronësimi kundrejt një shpërblimi më të ulët se vlera e tregut mund të justifikohet vetëm në kuadër të reformave të veçanta politike, sociale ose ekonomike dhe jo në rastet e shpronësimeve individuale për realizimin e objekteve specifike publike, ndërsa në rastin e tij ka mbajtur qëndrim të ndryshëm pa dhënë arsye objektive. Po kështu, për pjesë të së njëjtës pasuri, të shpronësuara në faza të ndryshme të realizimit të projektit publik, janë zbatuar vlera shpronësimi thelbësisht të ndryshme. Gjykatat gjithashtu kanë mbajtur qëndrim të ndryshëm nga praktika e konsoliduar e Gjykatës së Lartë për shpërblimin e drejtë, sipas së cilës ky shpërblim nuk identifikohet automatikisht me çmimin e caktuar nga organi publik, por ai duhet të jetë proporcional dhe i kënaqshëm në raport me vlerën reale dhe rrethanat konkrete të pronës. Në këto kushte, ai ka pasur pritshmëri të ligjshme se kriteret ligjore dhe praktika gjyqësore do të zbatoheshin në mënyrë të njëjtë edhe në rastin e tij dhe se situata e pronës së tij nuk do të përkeqësohej në mënyrë të pajustifikuar.

12.3. *E drejta e pronës private në aspektin e shpërblimit të drejtë,* e garantuar nga neni 41 i Kushtetutës, në lidhje me nenet 11 dhe 17 të saj dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, pasi pasuritë e tij janë shpronësuar me çmimin 347 lekë/m^2, dukshëm më të ulët sesa vlera reale e tregut. Masa e shpërblimit nuk ruan një marrëdhënie të arsyeshme proporcionaliteti ndërmjet interesit publik dhe mbrojtjes së pronës private, pasi në përcaktimin e saj nuk janë zbatuar kriteret e nenit 17, pika 2, të Ligjit të Shpronësimit dhe kriteret teknike të parashikuara nga aktet nënligjore përkatëse, që lidhen, ndër të tjera, me vlerën fillestare, destinacionin, vendndodhjen dhe ndryshimet e çmimeve të tregut. Nuk janë marrë në konsideratë as rrethanat konkrete të pasurisë, përfshirë pozicionimin e saj, lidhjen me rrugët kombëtare, zhvillimet e zonës dhe destinacionin faktik pas realizimit të veprës publike. Akti i ekspertimit, kontratat e shitblerjes dhe dokumentacioni zyrtar i administruar gjatë gjykimit tregonin vlera dukshëm më të larta se ajo e përdorur për shpronësim. Për më tepër, një pjesë e së njëjtës pasuri ishte shpronësuar në vitin 2006 me çmimin 900 lekë/m^2, kundrejt 347 lekë/m^2 në vitin 2015, pa u shpjeguar kjo diferencë. Shpërblimi i caktuar nuk i mundëson kërkuesit të zëvendësojë pronën e humbur me një pasuri të krahasueshme në të njëjtën zonë. Për rrjedhojë, shpërblimi nuk ruan një lidhje të arsyeshme me vlerën e pronës dhe e ngarkon atë me një barrë individuale të tepruar,

ndërsa fakti se shpronësimi është kryer për realizimin e një vepre publike nuk përjashton detyrimin për shpërblim të drejtë. Për këto arsye, vendimet gjyqësore që kanë lënë në fuqi masën e shpërblimit të përcaktuar nga organet publike kanë cenuar thelbin e së drejtës së pronës dhe nuk i kanë garantuar atij një shpërblim të drejtë sipas nenit 41 të Kushtetutës.

13. ***Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave,*** në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar se:

13.1. Kërkuesi nuk ka shteruar mjetet juridike efektive për pretendimin e cenimit të *së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm*, pasi nuk ka përdorur mjetin juridik të parashikuar nga KPC-ja, konkretisht paraqitjen e kërkesës në Gjykatën e Lartë për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurës së gjykimit në Gjykatën Administrative të Apelit, për të cilën pretendon se ka qenë në vonesë.

13.2. Pretendimi për cenimin e *së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme* është i pabazuar, pasi argumentet e kërkuesit janë të pamjaftueshme nga pikëpamja kushtetuese për të provuar, sipas testit subjektiv ose atij objektiv, ekzistencën e rrethanave që vënë në dyshim paanshmërinë e gjykatave.

13.3. Është i pabazuar edhe pretendimi për cenimin e *parimit të barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit,* pasi kërkuesi ka pasur mundësi të barabarta me palët e tjera për të marrë pjesë në proces, për t'u njohur me aktet, për të paraqitur prova dhe argumente, si dhe për të ushtruar mjetet e ankimit. Çështja në gjykatën e shkallës së parë është shqyrtuar në seancë publike. Kërkuesi, po ashtu, është njoftuar për shqyrtimin e çështjes në gjykatën e apelit dhe ka ushtruar të drejtat e tij procedurale, përfshirë edhe paraqitjen e kërkesës për heqjen dorë nga gjykimi i kërkimit të padisë që lidhej me sipërfaqen 770 m^2. Gjithashtu, ai ka ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë, e cila ka shqyrtuar dhe vlerësuar pretendimet e të gjitha palëve ndërgjyqëse. Për rrjedhojë, kërkuesi nuk është vendosur në pozitë të pafavorshme ndaj palëve të tjera.

13.4. Pretendimi për cenimin e *parimit të sigurisë juridike, në aspektin e pritshmërive të ligjshme,* është i pabazuar, pasi argumentet e kërkuesit lidhen me interpretimin dhe zbatimin në kohë të ligjit nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, çështje që nuk përfshihet në juridiksionin kushtetues. Po kështu, në mungesë të një vendimi njësues

të Gjykatës së Lartë për çështje të kësaj natyre, nuk mund të pretendohet shmangie nga një praktikë e konsoliduar.

13.5. Është i pabazuar edhe pretendimi për cenimin e *standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor të lidhur me të drejtën për shpërblim të drejtë dhe parimin e proporcionalitetit.* Kundërshtimet e kërkuesit lidhen, në thelb, me vlerësimin e provave dhe me interpretimin e ligjit nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm. Gjykata Administrative e Apelit ka analizuar Ligjin e Shpronësimit dhe aktet nënligjore në fuqi në kohën e shpronësimit, duke arsyetuar se masa e shpërblimit ishte përllogaritur sipas VKM-së së Vlerës së Pronës 2013 dhe VKM-së së Kritereve Teknike të Vlerësimit. Referuar edhe jurisprudencës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*GJEDNJ*) në çështjen *Vrioni etj., kundër Shqipërisë*, masa e shpërblimit nuk mund të mbështetet *a priori* në shumën e kërkuar nga pala ose atë të përcaktuar nga eksperti, por duhet të marrë në konsideratë metodologjinë e përcaktuar nga autoritetet e shtetit në mënyrë që ky i fundit të mos cenohet në përmbushjen e interesit publik. Në këtë kuptim, për sa kohë shpërblimi është përcaktuar sipas kuadrit ligjor dhe metodologjisë në fuqi, interpretimi nga gjykatat e zakonshme i konceptit të "shpërblimit të drejtë" nuk rezulton arbitrar ose joproporcional. Kërkuesi nuk ka paraqitur argumente konkrete që provojnë se masa e shpërblimit është caktuar në mënyrë arbitrare, se i ka cenuar thelbin e së drejtës së pronës ose që e ka ngarkuar me barrë individuale të tepruar, por ka shprehur pakënaqësi për vlerën dhe metodën e përllogaritjes. Po kështu, vendimet e kundërshtuara përmbushin standardin kushtetues të arsyetimit. Gjykata Administrative e Apelit ka paraqitur rrethanat e çështjes, faktet, provat dhe dispozitat ligjore mbi të cilat ka mbështetur përfundimin e saj, ndërsa Gjykata e Lartë ka pasqyruar vendimet e gjykatave më të ulëta, shkaqet e rekursit dhe ligjin e zbatueshëm, duke përmbajtur edhe pjesën arsyetuese ku mbështetet qëndrimi i shprehur në dispozitiv. Arsyetimi i kufizuar i vendimit për mospranimin e rekursit nuk përbën cenim, për sa kohë, përmes parashtrimit të shkaqeve të tij, Gjykata e Lartë tregon se, pas vlerësimit të tyre, ka arritur në përfundimin se ato nuk gjenin mbështetje në shkaqet e parashikuara nga neni 58 i ligjit nr. 49/2012.

14. ***Subjekti i interesuar, ARRSH-ja*** në mënyrë të përmbledhur, ka kundërshtuar pretendimet e kërkuesit për cenimin e *standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor të lidhur me të*

drejtën për shpërblim të drejtë dhe parimin e proporcionalitetit, duke parashtruar të njëjtat prapësime me ato të Këshillit të Ministrave.

15. ***Subjekti i interesuar, MIE,*** nuk ka paraqitur prapësime me shkrim, megjithëse është njoftuar rregullisht nga Gjykata.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për kriteret e pranueshmërisë së kërkesës

16. Çështja e legjitimimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f", dhe 134, pikat 1, shkronja "i", dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave edhe kundër çdo vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

17. Në rastin në shqyrtim, Gjykata vlerëson se kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja "f", dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor të kundërshtuar dhe ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar, në të cilën është disponuar për masën e shpërblimit për shpronësimin e pasurive të tij.

18. Në lidhje me kriterin *e shterimit të mjeteve juridike efektive*, të parashikuar në nenin 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës, Gjykata ka pohuar se shterimi i mjeteve përbën parakusht që duhet të përmbushet nga kërkuesi, i cili, përpara se t'i drejtohet Gjykatës, duhet të vërtetojë se i ka përdorur të gjitha mjetet juridike efektive të njohura nga ligji dhe të mjaftueshme për të rivendosur të drejtat e shkelura. Ky rregull nënkupton jo vetëm që individi t'u jetë drejtuar të gjitha instancave të zakonshme, por edhe pretendimet që ngre në këtë Gjykatë t'i ketë paraqitur më parë në këto instanca, të paktën në substancë, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural (*shih vendimet nr. 12, datë 09.03.2021; nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 8, datë 19.03.2018 të Gjykatës Kushtetuese*). Për pretendimet që lidhen me tejzgjatjen e gjykimit ose zvarritjen e procedurave, Gjykata ka theksuar se mjeti juridik i parashikuar nga nenet 399/1 e vijues të KPC-së duhet të shterohet fillimisht përpara gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, ndërsa Gjykata investohet vetëm kur ky mjet është shteruar ose kur provohet se ai nuk

ka qenë efektiv në rrethanat konkrete. Për këtë arsye, individi duhet të tregojë kujdesin e duhur, duke përdorur në kohën e duhur kërkesën për konstatimin e shkeljes dhe përshpejtimin e procedurave *(shih vendimet nr. 58, datë 17.09.2024; nr. 43, datë 04.06.2024; nr. 11, datë 28.02.2024 të Gjykatës Kushtetuese).*

19. Në zbatim të këtyre standardeve, Gjykata vëren se, për pretendimin e cenimit të *së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm* kërkuesi nuk ka shteruar mjetet juridike efektive, pasi nuk rezulton të ketë përdorur mjetin e parashikuar nga nenet 399/1 e vijues të KPC-së për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurës së gjykimit në Gjykatën Administrative të Apelit. Ky mjet juridik, i parashikuar me ndryshimet e KPC-së të bëra me ligjin nr. 38/2017 ka qenë në dispozicion të kërkuesit nga data 05.11.2017, kur këto ndryshime kanë hyrë në fuqi, ndërkohë që gjykimi i çështjes në gjykatën e apelit ka përfunduar në datën 31.05.2018. Në të tilla rrethana, kërkuesi ka pasur mundësinë ta përdorte këtë mjet gjatë kohës që procesi gjyqësor në gjykatën e apelit ishte ende në zhvillim. Megjithatë, nuk rezulton që ai ta ketë ushtruar këtë mjet dhe as ka parashtruar rrethana që të vinin në dyshim efektivitetin e tij në rastin konkret. Për rrjedhojë, ky pretendim i kërkuesit nuk mund të merret në shqyrtim.

20. Për sa u përket pretendimeve të tjera të kërkuesit, që lidhen me procesin gjyqësor të kundërshtuar, Gjykata vëren se ato janë ngritur më parë prej tij, të paktën në substancë, përpara gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, ndërsa pretendimet për mangësitë e vet vendimit të Gjykatës së Lartë nuk mund të paraqiteshin përpara dhënies së tij. Për rrjedhojë, për këto pretendime, kriteri i shterimit të mjeteve juridike efektive konsiderohet i përmbushur.

21. Gjykata vlerëson se plotësohet edhe kriteri *ratione temporis*, bazuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja "b", të Ligjit Organik të Gjykatës, pasi vendimi më i fundit i kundërshtuar, ai i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, mban datën 03.06.2025 dhe, sipas informacionit të përcjellë nga ajo gjykatë, është publikuar në datën 10.07.2025, ndërsa ankimi kushtetues individual është paraqitur në datën 10.11.2025, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

22. Në drejtim të kriterit *ratione materiae*, pas përjashtimit të pretendimit për kohëzgjatjen e gjykimit në gjykatën e apelit, kërkuesi ka ngritur pretendime për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në aspektet e aksesit substancial në gjykatë, gjykimit nga një gjykatë e paanshme, barazisë së armëve dhe standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, të parimeve të barazisë përpara ligjit dhe të sigurisë juridike në aspektin e pritshmërive të ligjshme, si dhe së drejtës së pronës private, në aspektin e shpërblimit të drejtë, pretendime që lidhen me garancitë e neneve 4, 18, 41, 42 dhe 142 të Kushtetutës.

23. Për sa i takon s*ë drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme dhe parimit të barazisë së armëve,* kërkuesi ka parashtruar se gjykatat kanë mbajtur qëndrim të njëanshëm në favor të administratës. Në veçanti, sipas tij, Gjykata Administrative e Apelit është përqendruar gjerësisht në shqyrtimin e ankimeve dhe pretendimeve të organeve publike, ndërsa nuk u ka dhënë të njëjtën vëmendje pretendimeve dhe argumenteve të tij. Po sipas kërkuesit, gjykatat kanë pranuar *a priori* aktet e vlerësimit të palëve të paditura dhe nuk u kanë dhënë të njëjtën peshë provave shkresore, aktit të ekspertimit dhe argumenteve të tij, duke e vendosur atë në pozitë të pabarabartë me administratën.

24. Gjykata ka pohuar se respektimi i së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme duhet të verifikohet sipas testit subjektiv dhe atij objektiv. Testi subjektiv kërkon të provuarit e faktit që bindja personale ose interesi i një gjyqtari kanë ndikuar në vendimin e gjykatës, ndërsa testi objektiv kërkon të provuarit nëse gjyqtari ka ofruar garanci të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim të arsyeshëm për paanshmërinë e tij. Në kuptim të testit objektiv, përtej sjelljes personale të çdo anëtari të trupit gjykues, duhet të provohet nëse ka fakte bindëse të cilat vënë në dyshim paanshmërinë e tij. Ndërsa në kuptim të testit subjektiv, paanshmëria personale e gjyqtarëve prezumohet derisa të provohet e kundërta *(shih vendimet nr. 10, datë 12.04.2022; nr. 10, datë 13.02.2017; nr. 49, datë 10.07.2015 të Gjykatës Kushtetuese)*. Nga ana tjetër, parimi i barazisë së armëve kërkon që secila palë në proces të ketë mundësi të barabarta për të paraqitur çështjen e saj dhe asnjëra prej tyre nuk duhet të gëzojë avantazh të konsiderueshëm ndaj palës tjetër, por duhet të garantohet një ekuilibër i drejtë mes tyre. Në këtë kuptim, gjykata duhet t'u japë palëve mundësinë të shprehen për faktet, provat dhe vlerësimet ligjore që lidhen ngushtë me çështjen *(shih vendimet nr. 19, datë 01.04.2021; nr. 21, datë 20.03.2017; nr. 28, datë 22.05.2015 të Gjykatës Kushtetuese)*.

25. Në rastin konkret, Gjykata vëren se kërkuesi nuk ka paraqitur fakte që lidhen me sjelljen ose interesin personal të gjyqtarëve dhe as rrethana të jashtme që krijojnë dyshime objektivisht të justifikuara për paanshmërinë e tyre. Po kështu, nuk rezulton që atij t'i jetë mohuar mundësia për të paraqitur pretendimet, argumentet dhe provat e veta ose për të kundërshtuar ato të palëve të tjera. Fakti se gjykatat nuk u kanë dhënë provave të tij vlerën provuese të pretenduar nuk provon, në vetvete, cenimin e paanshmërisë ose të barazisë së armëve. Këto garanci procedurale nuk nënkuptojnë detyrimin e gjykatës për t'u dhënë provave të palëve të njëjtën vlerë provuese, por kërkojnë që secilës palë t'i sigurohen mundësi të përshtatshme për paraqitjen dhe mbrojtjen e qëndrimit të saj në proces. Në këtë kuptim, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkuesit për

cenimin e paanshmërisë dhe të barazisë së armëve janë haptazi të pabazuara, pasi argumentet e tij nuk evidentojnë cenime të këtyre garancive procedurale, por lidhen, në thelb, me mënyrën e vlerësimit të provave dhe me arsyetimin e vendimeve gjyqësore. Ndërsa për aq sa këto argumente kanë të bëjnë me mungesën e një përgjigjeje të arsyetuar ndaj pretendimeve të tij thelbësore, ato do të analizohen në kuadër të pretendimeve të kërkuesit për cenimin e së drejtës së aksesit substancial në gjykatë dhe të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor.

26. Për sa u përket pretendimeve të tjera të kërkuesit, që lidhen me aksesin substancial në gjykatë, standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, barazinë përpara ligjit, sigurinë juridike dhe të drejtën e pronës private, Gjykata vëren se kërkuesi i ka ngritur ato në funksion të mbrojtjes të së drejtës për shpërblim të drejtë për pasuritë e shpronësuara, duke kundërshtuar masën e shpërblimit dhe efektivitetin e kontrollit gjyqësor për përcaktimin e saj. Sipas kërkuesit, gjykatat, veçanërisht Gjykata e Lartë, nuk u kanë dhënë përgjigje pretendimeve të tij për masën e shpërblimit, argumenteve të mbështetura në aktin e ekspertimit dhe provat e tjera shkresore, si dhe për qëndrimin e ndryshëm nga praktika gjyqësore në raste të ngjashme. Subjektet e interesuara, Këshilli i Ministrave dhe ARRSH-ja, kanë prapësuar se vendimet gjyqësore, përfshirë atë të Gjykatës së Lartë, përmbushin standardet kushtetuese të arsyetimit dhe se kundërshtimet e kërkuesit lidhen me interpretimin e ligjit dhe me vlerësimin e provave, ndaj nuk ngrenë çështje të natyrës kushtetuese. Sipas tyre, në mungesë të një vendimi njësues të Gjykatës së Lartë për çështje të kësaj natyre, nuk mund të pretendohet shmangie nga një praktikë e konsoliduar.

27. Neni 41 i Kushtetutës, krahas garantimit të së drejtës së pronës private (*pika 1*), përcakton, ndër të tjera, se ligji mund të parashikojë shpronësime ose kufizime në ushtrimin e së drejtës së pronës vetëm për interesa publikë (*pika 3)*, se shpronësimi dhe kufizimet e së drejtës së pronës që barazohen me të lejohen vetëm përkundrejt një shpërblimi të drejtë (*pika 4),* si dhe se për mosmarrëveshjet lidhur me masën e shpërblimit mund të bëhet ankim në gjykatë (*pika 5*).

28. Në jurisprudencën kushtetuese, për sa u takon garancive të nenit 41 të Kushtetutës, është pohuar se e drejta e pronës mund t'u nënshtrohet ndërhyrjeve në formën e *"shpronësimit"* ose të *"kufizimit".* Ndërhyrja në të drejtën e pronës duhet të realizohet me *"ligj", "vetëm për interesa publikë"* dhe *"vetëm përkundrejt një shpërblimi të drejtë"* (*shih vendimin nr. 17, datë 23.04.2010 të Gjykatës Kushtetuese*). Shpërblimi i drejtë është koncept kushtetues i lidhur me ndërhyrjen në të drejtën e pronës për interes publik dhe, në rastin e shpronësimit, marrëdhënia juridike krijohet midis individit pronar dhe shtetit, ku individi zhvishet nga e drejta e pronësisë

dhe ai ka të drejtë të kundërshtojë në gjykatë masën e shpërblimit të përcaktuar për pasurinë e shpronësuar *(shih vendimin nr. 4, datë 23.02.2016 të Gjykatës Kushtetuese).*

29. Në rastin konkret, Gjykata vëren se gjatë procesit gjyqësor të kundërshtuar nuk ka pasur mosmarrëveshje për faktin se pasuritë e kërkuesit janë shpronësuar në bazë të Ligjit të Shpronësimit, për realizimin nga ARRSH-ja të projektit rrugor "Nyja lidhëse Milot-Lezhë, Milot-Rrëshen dhe Milot-Thumanë". Kërkuesi nuk ka kundërshtuar shpronësimin si të tillë ose interesin publik të ndjekur, por proporcionalitetin e ndërhyrjes në të drejtën e tij të pronës dhe, konkretisht, masën e shpërblimit të përcaktuar për pasuritë e tij të shpronësuara. Megjithëse përcaktimi i masës konkrete të shpërblimit u takon gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, të cilat kanë kompetencën për të shqyrtuar dhe vlerësuar provat, si dhe për të kontrolluar ligjshmërinë e vlerësimit të kryer nga organet e administratës publike, Gjykata, në bazë të neneve 17 dhe 41, pika 4, të Kushtetutës, ka juridiksion të kontrollojë nëse ndërhyrja në të drejtën e pronës ka respektuar kërkesën kushtetuese të proporcionalitetit dhe nëse individit i është vendosur një barrë individuale e tepruar. Në këtë kuadër, kontrolli kushtetues përfshin edhe verifikimin e efektivitetit të mbrojtjes gjyqësore për garantimin e së drejtës për shpërblim të drejtë, pa zëvendësuar gjykatat e juridiksionit të zakonshëm në përcaktimin e masës konkrete të tij.

30. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se prapësimi i subjekteve të interesuara se pretendimet e kërkuesit nuk ngrenë çështje kushtetuese nuk është i bazuar, ndaj, në themel, do t'i shqyrtojë bashkërisht pretendimet për aksesin substancial në gjykatë dhe standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor të lidhura me garancinë e shpërblimit të drejtë dhe proporcionalitetin e ndërhyrjes në të drejtën e pronës. Argumentet e kërkuesit për qëndrimet e ndryshme gjyqësore do të merren në konsideratë për aq sa kanë rëndësi për vlerësimin e standardit të arsyetimit të vendimeve gjyqësore të kundërshtuara. Në varësi të përfundimeve të kësaj analize, Gjykata do të vlerësojë nëse është rasti të shqyrtojë veçmas edhe themelin e pretendimeve për cenimin e parimeve të barazisë përpara ligjit dhe të sigurisë juridike.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e së drejtës së aksesit substancial në gjykatë dhe të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor të lidhura me garancinë e shpërblimit të drejtë dhe me proporcionalitetin e ndërhyrjes në të drejtën e pronës

31. Kërkuesi, në thelb, ka pretenduar se gjykatat e juridiksionit të zakonshëm nuk i kanë siguruar mbrojtje gjyqësore efektive dhe nuk u kanë dhënë përgjigje të arsyetuara pretendimeve të

tij për masën e shpërblimit, kriteret e vlerësimit të pasurisë dhe qëndrimet e ndryshme gjyqësore në çështje të ngjashme. Ai ka kundërshtuar edhe trajtimin e kërkesës për heqjen dorë nga gjykimi i kërkimit të padisë që lidhej me sipërfaqen 770 m^2. Sipas tij, Gjykata e Lartë është mjaftuar me përfundimin e përgjithshëm se rekursi nuk përmbante shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 58 i ligjit nr. 49/2012, pa iu përgjigjur përmbajtjes së këtyre pretendimeve. Për rrjedhojë, sipas tij, mungesa e një shqyrtimi efektiv dhe e një arsyetimi të mjaftueshëm nuk ka mundësuar kontrollin e proporcionalitetit të ndërhyrjes në të drejtën e pronës, ndërsa masa e shpërblimit nuk ruan një lidhje të arsyeshme me vlerën e pronës dhe e ka ngarkuar atë me një barrë individuale të tepruar.

32. Subjektet e interesuara, Këshilli i Ministrave dhe ARRSH-ja, kanë prapësuar, në thelb, se pretendimet e kërkuesit lidhen me vlerësimin e provave dhe me interpretimin e ligjit nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, çështje që, sipas tyre, nuk përfshihen në juridiksionin kushtetues, për sa kohë nuk provohet arbitrariteti. Sipas tyre, masa e shpërblimit nuk mund të mbështetet *a priori* në shumën e kërkuar nga pala ose në atë të përcaktuar nga eksperti, por duhet të marrë në konsideratë metodologjinë e përcaktuar nga autoritetet e shtetit, në mënyrë që shteti të mos cenohet në përmbushjen e interesit publik. Në këtë kuptim, masa e shpërblimit për kërkuesin është përcaktuar në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi në kohën e shpronësimit, ndërsa vendimet gjyqësore përmbushin standardin kushtetues të arsyetimit. Po sipas tyre, arsyetimi i kufizuar i vendimit të Gjykatës së Lartë nuk përbën cenim të së drejtës së aksesit ose të standardit të arsyetimit, për sa kohë ajo ka vlerësuar se pretendimet e ngritura në rekursin e kërkuesit nuk gjenin mbështetje në shkaqet e parashikuara nga neni 58 i ligjit nr. 49/2012.

33. Gjykata ka pohuar se e drejta e individit të shpronësuar për të pasur akses në gjykatë, e parashikuar shprehimisht në nenin 41, pika 5, të Kushtetutës, përbën garanci specifike të së drejtës së pronës në rastin e shpronësimit. Nëpërmjet kësaj garancie procedurale, individit i jepet mundësia të realizojë edhe garancinë kushtetuese me natyrë materiale, atë të shpërblimit të drejtë. Në këtë kuptim, e drejta e aksesit lidhet nga pikëpamja organike dhe funksionale me të drejtën për shpërblim të drejtë. Aksesi në gjykatë i individit të shpronësuar duhet të garantojë ushtrimin efektiv të të drejtave të tij, duke i mundësuar atij mbrojtjen gjyqësore në rast arbitrariteti të ndërhyrjes shtetërore, si dhe kontrollin nëse kjo ndërhyrje në të drejtën e pronës private ka qenë proporcionale *(shih vendimet nr. 33, datë 30.05.2023; nr. 22, datë 25.04.2023; nr. 40, datë 22.12.2022 të Gjykatës Kushtetuese).*

34. E drejta për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar garantohet nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Funksioni i vendimit të arsyetuar është t'u tregojë palëve se ato janë dëgjuar,

si dhe t'u japë mundësinë ta kundërshtojnë atë. Ky standard nuk nënkupton se kërkohet arsyetim i detajuar për çdo pretendim të palëve, por ai varet nga natyra e vendimit (*shih vendimet nr. 17, datë 23.03.2023; nr. 80, datë 18.12.2017; nr. 34, datë 13.06.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Arsyetimi i kufizuar i vendimeve për mospranimin e rekursit, si rregull, nuk cenon standardin e arsyetimit. Megjithatë, kur në rekurs janë ngritur pretendime me natyrë kushtetuese, Gjykata e Lartë, në respektim të parimit të subsidiaritetit që udhëheq raportet ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, duhet të investohet në shqyrtimin e tyre dhe të mbajë një qëndrim të shprehur për to në raport me përfundimin e arritur për mospranimin e rekursit *(shih vendimet nr. 19, datë 07.07.2022; nr. 11, datë 16.04.2018; nr. 45, datë 03.07.2017 të Gjykatës Kushtetuese)*.

35. Gjykata ka pohuar se e drejta e individit të shpronësuar për shpërblim të drejtë përbën garanci kushtetuese me natyrë materiale. Neni 41 i Kushtetutës nuk përcakton kriteret, treguesit konkretë ose mekanizmin e përllogaritjes së "shpërblimit të drejtë", duke ia lënë ligjvënësit përcaktimin e parametrave përkatës. Megjithatë, Gjykata ka theksuar se koncepti kushtetues i "shpërblimit të drejtë" nuk mund të konsiderohet një formulim i zbrazët, edhe pse përcaktimi i kritereve për matjen e tij i është besuar ligjvënësit *(shih vendimet nr. 33, datë 30.05.2023; nr. 40, datë 22.12.2022; nr. 35, datë 10.10.2007 të Gjykatës Kushtetuese)*.

36. Gjykata ka vënë në dukje se shpronësimi, si ndërhyrje e bazuar në ligj dhe për interes publik, sjell humbjen e së drejtës së pronës private përkundrejt një shpërblimi të drejtë. Në përcaktimin e masës së këtij shpërblimi, ligjvënësi dhe ekzekutivi gëzojnë, si rregull, hapësirë të gjerë vlerësimi. Natyra e shpërblimit nga shpronësimi ndryshon nga ajo e dëmshpërblimit sipas së drejtës civile, pasi ai nuk synon rimbursimin e çdo humbjeje aktuale ose të ardhshme, por, në parim, rivendosjen e individit në një gjendje "të barasvlershme me gjendjen e mëparshme", duke marrë parasysh vlerën e pronës në kohën e shpronësimit dhe jo zhvillimet e saj të ardhshme. Thelbi i garancisë së nenit 41, pika 4, të Kushtetutës qëndron në ruajtjen e një ekuilibri të drejtë ndërmjet interesit publik dhe interesit pasuror të individit të shpronësuar. Shpërblimi mund të korrespondojë me vlerën e plotë të pronës, por në rrethana të caktuara mund të jetë edhe më i ulët, kur këtë e përligjin rrethanat konkrete dhe ruhet një marrëdhënie e arsyeshme proporcionaliteti ndërmjet masës së ndërhyrjes dhe interesit publik të ndjekur. Megjithatë, një shpërblim dukshëm i ulët mund t'i vendosë individit një barrë individuale të tepruar dhe, për këtë arsye, autoritetet kompetente gjatë procedurës së shpronësimit dhe, më tej, gjykatat e zakonshme gjatë procesit gjyqësor duhet të shqyrtojnë me kujdes të gjithë faktorët relevantë për përcaktimin e masës së shpërblimit, me

qëllim arritjen e ekuilibrit të duhur ndërmjet interesit individual dhe atij publik. Masa e shpërblimit nuk mund të përcaktohet duke marrë në konsideratë në mënyrë të njëanshme vetëm interesat e pronarit ose vetëm ato të publikut të gjerë *(shih vendimin nr. 82, datë 18.12.2025 të Gjykatës Kushtetuese).*

37. Gjykata ka theksuar se kontrolli kushtetues ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të garantimit të të drejtave kushtetuese të individit, kurse problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përfshihen në juridiksionin kushtetues nëse nuk shoqërohen me cenimin e këtyre të drejtave (*shih vendimet nr. 38, datë 02.12.2021; nr. 6, datë 16.02.2021; nr. 9, datë 26.03.2018 të Gjykatës Kushtetuese*). Detyrë e Gjykatës është të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që bie haptazi ndesh me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës. Ajo nuk vepron si shkallë e katërt gjykimi, por ndërhyn kur gabimi ligjor ose faktik i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e kujdesshme nuk mund ta kishte bërë atë ndonjëherë, ose është i tillë që e bën gjykimin të padrejtë *(shih vendimet nr. 59, datë 14.11.2023; nr. 30, datë 29.05.2023; nr. 29, datë 01.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

38. Në çështjen konkrete, Gjykata vëren se kërkuesi kundërshton vendimet e gjykatave të të tria shkallëve të gjykimit, të dhëna në procesin gjyqësor të filluar me padinë e tij për masën e shpërblimit nga shpronësimi dhe kompensimin për zhvlerësimin e sipërfaqes së mbetur jashtë tij. Në këtë proces, referuar akteve të dosjes gjyqësore të administruar për qëllime të gjykimit kushtetues, Gjykata vëren se ai ka kërkuar që shpërblimi të përcaktohej sipas vlerës së tregut ose, së paku, sipas vlerës prej 900 lekë/m^2, me të cilën në vitin 2006 ishte shpronësuar një pjesë e së njëjtës pasuri.

39. Gjykata konstaton se gjatë procedurës administrative të shpronësimit për realizimin e projektit "Nyja lidhëse Milot-Lezhë, Milot-Rrëshen dhe Milot-Thumanë", MTI-ja i ka kërkuar Ministrisë së Financave miratimin për ndjekjen e procedurës përjashtimore të vlerësimit, sipas VKM-së së Kritereve Teknike të Vlerësimit, për zonën kadastrale ku ndodheshin edhe pasuritë e kërkuesit. Kërkesa nuk është miratuar nga Ministria e Financave dhe, në vijim, me VKM-në nr. 511/2015 është vendosur shpronësimi edhe i tri pasurive të kërkuesit, me çmimin 347 lekë/m^2, të përllogaritur sipas VKM-së së Vlerës së Pronës 2013.

40. Kërkuesi e ka kundërshtuar në gjykatë masën e shpërblimit për shpronësim dhe Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin e datës 15.02.2016, ka pranuar

pjesërisht padinë, duke ndryshuar VKM-në nr. 511/2015 për pjesën që lidhej me masën e shpërblimit për pasuritë e tij. Ajo ka detyruar organet publike të paditura t'i paguanin kërkuesit diferencën e shpërblimit për pasuritë e shpronësuara, si dhe kompensimin për zhvlerësimin e sipërfaqes 770 m^2 që kishte mbetur jashtë shpronësimit. Për sa i përket masës së shpërblimit për pasuritë e shpronësuara, ajo gjykatë, në mënyrë të përmbledhur, ka arsyetuar se koncepti kushtetues i "shpërblimit të drejtë" nuk nënkupton realizimin e interesit më të lartë ekonomik të subjektit të shpronësuar, por akordimin e një mase shpërblimi të kënaqshme në raport me kushtet ekonomike dhe sociale në kohën e shpronësimit, duke mbajtur parasysh edhe interesin publik dhe përfitimet që sjell realizimi i veprës publike për komunitetin dhe për vetë pronarin.

41. Në rastin konkret, gjykata administrative e shkallës së parë ka administruar si prova një akt ekspertimi vlerësues, disa kontrata shitblerjeje dhe dokumente shkresore për çmimet e pasurive në të njëjtën zonë kadastrale me ato të kërkuesit. Në përfundim, ajo e ka vlerësuar të pabazuar pretendimin e kërkuesit për përcaktimin e shpërblimit në masën e vlerës së pronës sipas çmimit të tregut. Sipas gjykatës, metodologjia e përdorur nga organet publike të paditura për përcaktimin e shpërblimit mbështetej në *Ligjin e Shpronësimit, VKM-në e Kritereve Teknike të Vlerësimit* dhe *VKM-në e Vlerës së Pronës 2013*, të cilat ishin të zbatueshme në atë rast, ndaj përcaktimi i vlerës së pasurisë mbi këtë bazë nuk ishte arbitrar. Po kështu, bazuar në certifikatat e pronësisë, ajo ka vlerësuar se pasuritë e kërkuesit ishin të llojit "arë" dhe se masa e shpërblimit duhej të përcaktohej mbi këtë zë kadastral. Megjithatë, gjykata ka konstatuar se VKM-ja e Vlerës së Pronës 2013 ishte zbatuar gabim në rastin konkret, pasi, sipas saj, çmimi i zbatueshëm për zonën kadastrale ishte 381 lekë/m^2 dhe jo 347 lekë/m^2. Për këtë arsye, ajo i ka njohur kërkuesit shumën 202.776 lekë si diferencë shpërblimi për pasuritë e shpronësuara. Po ashtu, ajo i ka njohur atij edhe kompensimin për zhvlerësimin e sipërfaqes 770 m^2, e cila kishte mbetur jashtë shpronësimit, por kishte humbur pothuajse tërësisht vlerën për shkak të realizimit të veprës publike, duke e përcaktuar këtë kompensim në shumën 293.370 lekë, të llogaritur mbi bazën e të njëjtit çmim prej 381 lekë/m^2.

42. Pas ankimeve të paraqitura nga palët, çështja është shqyrtuar nga Gjykata Administrative e Apelit, e cila, me vendimin e datës 31.05.2018, ka ndryshuar vendimin e gjykatës administrative të shkallës së parë, duke pranuar pjesërisht padinë e kërkuesit dhe duke detyruar organet publike të paditura t'i paguanin atij kompensimin për zhvlerësimin e sipërfaqes 770 m^2 që kishte mbetur jashtë shpronësimit, ndërsa ka rrëzuar kërkimet e tjera të padisë. Për sa i përket masës së shpërblimit për pasuritë e shpronësuara, gjykata e apelit, në mënyrë të përmbledhur, ka

arsyetuar se duhej të verifikohej nëse vlera e përcaktuar nga organet publike përbënte shpërblim të drejtë dhe nëse gjatë përcaktimit të saj ishin respektuar kriteret e nenit 17 të Ligjit të Shpronësimit. Sipas saj, shpërblimi duhej të ishte i kënaqshëm për të shpronësuarin, por jo ekstrem, në përpjesëtim me qëllimin e shpronësimit dhe interesin publik të ndjekur. Gjykata e apelit ka evidentuar se, sipas VKM-së së Kritereve Teknike të Vlerësimit, vlerësimi i tokës bujqësore bëhej sipas çmimeve të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave, ndërsa çmimi mesatar i shitblerjeve, sipas të dhënave të administruara nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, përdorej vetëm në mungesë të një çmimi të miratuar për zonën përkatëse.

43. Në rastin konkret, gjykata e apelit ka vlerësuar se pasuritë e kërkuesit ishin tokë bujqësore, pasi certifikatat e pronësisë figuronin me zërin kadastral "arë", dhe se, në kohën e shpronësimit, ekzistonte një çmim i miratuar për këtë kategori prone. Sipas saj, VKM-ja e Vlerës së Pronës 2013 përcaktonte, për zonën ku ndodheshin pasuritë e kërkuesit, vlerën 347 lekë/m², e cila ishte zbatuar edhe nga organet publike të paditura. Për rrjedhojë, ajo ka çmuar se vlera e pronës nuk ishte përcaktuar në mënyrë arbitrare, por sipas metodologjisë dhe procedurës së parashikuar në kuadrin ligjor dhe nënligjor të zbatueshëm në atë rast. Mbi këtë bazë, gjykata e apelit i ka vlerësuar të pabazuara pretendimet e kërkuesit për shpërblimin sipas vlerës së tregut ose për zbatimin e vlerës prej 900 lekë/m² të përcaktuar me VKM-në nr. 802/2006. Ajo ka evidentuar gjithashtu se edhe vetë kërkuesi nuk kundërshtonte saktësinë e përllogaritjes së shpërblimit sipas çmimit 347 lekë/m^2, por përdorimin e këtij çmimi. Për këtë arsye, gjykata e apelit ka rrëzuar kërkimin e padisë për pagimin e diferencës së shpërblimit për pasuritë e shpronësuara. Për sipërfaqen 770 m^2, që kishte mbetur jashtë shpronësimit, gjykata e apelit ka shqyrtuar fillimisht kërkesën e kërkuesit për heqjen dorë nga gjykimi i këtij kërkimi. Ajo ka pranuar se, sipas dispozitave kalimtare të ligjit nr. 38/2017, zbatohej neni 201 i KPC-së sipas përmbajtjes së tij përpara ndryshimeve, por e ka interpretuar shprehjen "në çdo fazë të gjykimit" si të kufizuar vetëm në fazat e gjykimit në gjykatën e shkallës së parë. Për rrjedhojë, ka çmuar se kërkuesi nuk mund të hiqte dorë nga gjykimi i këtij kërkimi gjatë gjykimit në gjykatën e apelit. Në vijim, gjykata e apelit e ka vlerësuar të drejtë kompensimin për zhvlerësimin e kësaj sipërfaqeje, por, ndryshe nga gjykata administrative e shkallës së parë, ka çmuar se çmimi i zbatueshëm sipas VKM-së së Vlerës së Pronës 2013 ishte 347 lekë/m^2 dhe jo 381 lekë/m^2. Për këtë arsye, kompensimi është përcaktuar në shumën 267.190 lekë.

44. Në vijim, kërkuesi ka paraqitur rekurs, duke pretenduar, ndër të tjera, se gjykatat e faktit nuk kishin zhvilluar një hetim të plotë dhe të gjithanshëm, si dhe nuk kishin vlerësuar siç

duhej provat e administruara, përfshirë aktin e ekspertimit, kontratat e shitblerjes dhe dokumentacionin zyrtar për çmimet e pasurive në të njëjtën zonë kadastrale. Sipas tij, këto prova tregonin se vlera e tregut ishte dukshëm më e lartë se çmimi 347 lekë/m^2 i përdorur për shpronësim, ndërsa gjatë procedurës administrative vetë MTI-ja kishte kërkuar zbatimin e procedurës përjashtimore të vlerësimit, duke iu referuar çmimit mesatar të shitblerjeve prej 751,54 lekë/m^2. Kërkuesi ka kundërshtuar edhe mungesën e arsyetimit për diferencën ndërmjet çmimit 900 lekë/m^2, me të cilin ishte shpronësuar një pjesë e së njëjtës pasuri në vitin 2006 dhe çmimit 347 lekë/m^2, të zbatuar për pjesën tjetër në vitin 2015, si dhe mosshqyrtimin e pretendimit se, për shkak të projektit dhe lejes së ndërtimit të rrugës, pasuritë nuk duhej të trajtoheshin më sipas zërit kadastral "arë".

45. Në veçanti, kërkuesi ka pretenduar se Gjykata Administrative e Apelit kishte cenuar standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, pasi nuk u kishte dhënë përgjigje shkaqeve konkrete të ankimit për zbatimin e gabuar të ligjit material dhe procedural dhe nuk kishte marrë në konsideratë në arsyetimin e saj aktin e ekspertimit dhe provat e tjera të administruara, ndërsa kishte trajtuar gjerësisht pretendimet e organeve publike të paditura. Po kështu, ai ka pretenduar se ajo gjykatë kishte mbajtur qëndrim të ndryshëm nga vendime të tjera të saj për çështje me të njëjtat shkaqe dhe objekt, në të cilat kishte pranuar se shpronësimi kundrejt një shpërblimi më të ulët se vlera e tregut mund të justifikohej vetëm në kuadër të reformave të veçanta politike, sociale ose ekonomike dhe jo në rastet e shpronësimeve individuale për realizimin e veprave publike specifike, duke iu referuar edhe jurisprudencës së GJEDNJ-së në çështjen *Scordino kundër Italisë (nr. 1) (vendimi i Dhomës së Madhe i datës 29.03.2006).* Në këtë drejtim, kërkuesi ka pretenduar edhe cenimin e parimit të pritshmërive të ligjshme për shkak të trajtimit të ndryshëm të së njëjtës pasuri në faza të ndryshme të realizimit të të njëjtit projekt publik. Kërkuesi ka kundërshtuar gjithashtu refuzimin e kërkesës së tij për heqjen dorë nga gjykimi i kërkimit të tretë të padisë, duke pretenduar se, sipas legjislacionit procedural të zbatueshëm në kohë, këtë të drejtë mund ta ushtronte në çdo fazë të gjykimit, përfshirë edhe në apel, dhe se disponimi i gjykatës për këtë kërkim, pavarësisht kërkesës së tij për heqjen dorë, binte ndesh edhe me parimin e disponibilitetit të padisë.

46. Rekursi i kërkuesit është shqyrtuar nga Gjykata e Lartë në dhomën e këshillimit, e cila, me vendimin e datës 03.06.2025, ka vendosur mospranimin e tij, duke arsyetuar se nuk përmbante shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 58 i ligjit nr. 49/2012. Sipas Gjykatës së Lartë, në rekurs nuk ishte parashtruar asnjë argument i qenësishëm që të lidhej me ndonjërin prej shkaqeve për të cilat ligji lejon ushtrimin e së drejtës së rekursit, nuk kishte ndonjë çështje ligjore që mund të

shqyrtohej kryesisht prej saj dhe pretendimet e ngritura kishin të bënin me vlerësimin e provave, çështje që dilnin jashtë kompetencës rishikuese të saj.

47. Në kushtet kur Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit, pa e shqyrtuar çështjen në themel, Gjykata vlerëson se kontrolli kushtetues duhet të përqendrohet te vendimi i saj, në respektim të parimit të subsidiaritetit dhe të kufijve ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe atij të gjykatave të zakonshme. Në këtë kuadër, duhet të verifikohet fillimisht nëse pretendimet e ngritura në rekurs kishin natyrë kushtetuese dhe nëse Gjykata e Lartë u ka dhënë përgjigje të arsyetuara, në përputhje me garancitë e aksesit substancial në gjykatë dhe arsyetimit të vendimit gjyqësor, në funksion të mbrojtjes të së drejtës për shpërblim të drejtë.

48. Nga përmbajtja e rekursit, Gjykata vëren se kërkuesi nuk është kufizuar vetëm në kundërshtimin e mënyrës së vlerësimit të provave nga gjykatat e faktit, por ka ngritur edhe pretendime për zbatimin e gabuar të ligjit material dhe procedural, pamjaftueshmërinë e arsyetimit të vendimeve dhe shmangien nga praktika gjyqësore. Përmbajtja e këtyre pretendimeve, të parashtruara më sipër, kërkonte vlerësim në raport me garancitë kushtetuese, cenimin e të cilave kërkuesi e kishte ngritur në substancë.

49. Në lidhje me kuadrin ligjor të vlerësimit të pasurisë që shpronësohet, Gjykata vëren se neni 17, pika 2, i Ligjit të Shpronësimit përcakton kriteret që duhet të merren në konsideratë sipas natyrës së saj, përfshirë vlerën fillestare, amortizimin, destinacionin, vendndodhjen dhe indekset e ndryshimit të çmimeve të tregut dhe të monedhës. Pika 3 e këtij neni ngarkon Këshillin e Ministrave për përcaktimin e kritereve të tjera teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës së shpërblimit. Ndërsa neni 19 i këtij ligji, sipas përmbajtjes së tij në kohën e shpronësimit, parashikonte përllogaritjen e shpërblimit mbi bazën e vlerës që rezultonte nga vlerësimi përfundimtar i pasurisë, në masë të njëjtë me vlerën e plotë të saj. Në nivel nënligjor, VKM-ja e Vlerës së Pronës 2013 mbështetej edhe në metodologjinë e miratuar me vendimin nr. 658, datë 26.09.2012 "Për miratimin e metodologjisë për vlerësimin e pronave të paluajtshme në Republikën e Shqipërisë" të Këshillit të Ministrave. Kjo metodologji parashikonte përllogaritjen e vlerave mbi bazën e të dhënave zyrtare të kontratave të shitjes, sipas llojit të pasurisë dhe zonës kadastrale. Në këtë kuadër, pretendimet e kërkuesit për kriteret dhe metodën e përcaktimit të shpërblimit kërkonin vlerësim të përmbajtjes së tyre dhe nuk mund të trajtoheshin në mënyrë të përgjithshme vetëm si kundërshtime për çmuarjen e provave. Ekzistenca e një vlere të miratuar me akt nënligjor nuk e përjashtonte shqyrtimin gjyqësor efektiv të pretendimeve për respektimin e garancisë kushtetuese të shpërblimit të drejtë.

50. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se diferencat ndërmjet vlerave të shpronësimit të zbatuara në vitet 2006 dhe 2015, si dhe vlerat e pasqyruara në dokumentacionin e administruar gjatë gjykimit, përbënin rrethanat mbi të cilat kërkuesi mbështeste pretendimin për mungesën e një marrëdhënieje të arsyeshme ndërmjet shpërblimit dhe vlerës së pasurisë. Po kështu, kundërshtimi i kërkuesit për statusin dhe destinacionin e pasurisë lidhej me kriteret e përdoruara për vlerësimin e saj. Në këtë kontekst, pretendimet e kërkuesit për mungesën e një përgjigjeje të arsyetuar për këto çështje vinin në diskutim efektivitetin e mbrojtjes gjyqësore të së drejtës për shpërblim të drejtë, në kuptim të neneve 41, pikat 4 dhe 5, 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Për këtë arsye, ato kërkonin përgjigje nga Gjykata e Lartë në ushtrim të juridiksionit të saj rishikues. Mungesa e referimit të shprehur në rekurs te dispozitat kushtetuese përkatëse nuk e ndryshon natyrën e pretendimeve, për sa kohë ato ishin ngritur në substancë.

51. Gjykata vëren se Gjykata e Lartë i ka trajtuar pretendimet e kërkuesit në mënyrë të përgjithshme si kundërshtime për vlerësimin e provave, pa dhënë përgjigje për aspektet e evidentuara më lart. Arsyetimi i vendimit të saj nuk shpjegon se përse pretendimet për zbatimin e kritereve ligjore të shpërblimit dhe për mjaftueshmërinë e mbrojtjes gjyqësore të kësaj të drejte nuk kërkonin shqyrtim në kuadër të shkaqeve ligjore të rekursit. Mangësia e konstatuar qëndron në mungesën e përgjigjes ndaj përmbajtjes kushtetuese të këtyre pretendimeve. Për këtë arsye, ndonëse arsyetimi i kufizuar i vendimeve për mospranimin e rekursit është, si rregull, i pranueshëm, në rastin konkret ai nuk ka siguruar mbrojtjen gjyqësore efektive të kërkuesit.

52. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se kërkuesit i janë cenuar e drejta e aksesit substancial në gjykatë dhe standardi i arsyetimit të vendimit gjyqësor, të garantuara nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës, në lidhje me garancinë e shpërblimit të drejtë sipas nenit 41, pikat 4 dhe 5, të saj. Në këto kushte, vendimi i Gjykatës së Lartë duhet të shfuqizohet për pjesën që lidhet me rekursin e kërkuesit dhe çështja t'i dërgohet asaj për rishqyrtim.

53. Duke pasur parasysh përfundimin e mësipërm dhe natyrën subsidiare të kontrollit kushtetues të kërkesave individuale, Gjykata nuk ndalet në këtë gjykim në vlerësimin e bazueshmërisë së pretendimeve të kërkuesit për masën e shpërblimit dhe kriteret e përdorura për përcaktimin e saj, pasi i takon Gjykatës së Lartë, gjatë rishqyrtimit të çështjes, të vlerësojë aspektet kushtetuese të këtyre pretendimeve dhe t'u japë përgjigje të arsyetuara, duke mbajtur në konsideratë standardet kushtetuese të evidentuara në këtë vendim për të drejtën për shpërblim të drejtë dhe proporcionalitetin e ndërhyrjes në të drejtën e pronës. Po kështu, në kushtet e shkeljeve të konstatuara, Gjykata çmon se nuk është e nevojshme të ndalet në shqyrtimin e veçantë të

pretendimeve të kërkuesit për cenimin e parimeve të barazisë përpara ligjit dhe të sigurisë juridike, vlerësimi i të cilave i takon Gjykatës së Lartë gjatë rishqyrtimit të çështjes. Gjithashtu, në kuadër të këtij rishqyrtimi mbetet edhe pretendimi i kërkuesit në lidhje me trajtimin e kërkesës së tij për heqjen dorë nga gjykimi i njërit prej kërkimeve të padisë.

54. Në përfundim, Gjykata çmon se pretendimet e kërkuesit për cenimin e së drejtës së aksesit substancial në gjykatë dhe të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, të lidhura me proporcionalitetin e ndërhyrjes në të drejtën e pronës, janë të bazuara, sipas arsyetimit të mësipërm të këtij vendimi, ndaj kërkesa pranohet pjesërisht.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "f", dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, si dhe nenit 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, njëzëri,

V E N D O S I:

1. Pranimin e pjesshëm të kërkesës.
2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2025-2119, datë 03.06.2025 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, për pjesën që lidhet me rekursin e kërkuesit, si të papajtueshëm me Kushtetutën.
3. Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 24.09.2026

Shpallur më 22.10.2026